



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 18, Datë 26.02.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN NR. 48, DATË 30.06.2015 “PËR
KRITERET, PROCEDURAT DHE AFATET E LICENCIMIT SI DHE RASTET E
REFUZIMIT TË LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BROKERIMI NË
SIGURIME”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar dhe Kodit të Procedurës Administrative, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Në rregulloren nr. 48, datë 30.06.2015, “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, pika 2 e nenit 9, ndryshon si më poshtë:
 - a- Banka dhe/ose dega e bankës së huaj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit duhet t’i ofrojë në mënyrë transparente klientit çdo policë sigurimi që ndërmjetëson. Klienti ka të drejtë të zgjedhë policën e sigurimit.
 - b- Banka dhe/ose dega e bankës se huaj duhet të respektojë kërkesat e ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” në ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI